

1. Sa titullarë ka pasur institucioni në periudhën 2019-2023 dhe në cilat vite saktësisht kanë ndodhur ndërrimet ?

Gjatë periudhës 2019-2023 AAC ka patur 3 Drejtorë Ekzekutivë përkatësisht:

- ✓ 13.11.2017 – 22.04.2020
- ✓ 22.04.2020 – 01.12.2021
- ✓ 01.12.2021 dhe në vazhdim

2. Sa është numri i punonjësve të larguar nga institucioni për periudhën 2019-2023 sipas tabelës më poshtë:

Numri i punonjësve të larguar nga institucioni për periudhën 2019-2023									
Numri i punonjësve që kanë dhënë dorëheqjen					Numri i punonjësve të larguar për shkak të ligjit (duke përfshirë edhe pushimet nga puna)				
2019	2020	2021	2022	2023	2019	2020	2021	2022	2023
3	4	2	2	2	1 (Punonjësi ka ndruar jetë)	2 (1 pension pleqërie dhe 1 transferim i përhershëm)	2 (pension pleqërie)	2 (1 pension pleqërie dhe 1 largim nga shërbimi civil)	4 (3 pension pleqërie dhe 1 punonjës ka refuzuar pozicionin e ofruar për shkak të ristrukturimit institucioni)

3. Sa është numri i punonjësve që kanë pezulluar statusin dhe (nuk) janë rikthyer për periudhën 2019-2023 sipas tabelës më poshtë:

Numri i punonjësve që kanë pezulluar statusin dhe janë rikthyer në institucion për periudhën 2019-2023									
Numri i punonjësve që kanë pezulluar statusin					Numri i punonjësve që janë rikthyer në institucion				
2019	2020	2021	2022	2023	2019	2020	2021	2022	2023
-	3	3	1	-	-	-	1	-	-

- 3.1 Nëse punonjësit nuk janë rikthyer në pozicionet e mëparshme në institucion, cilat janë arsyet?

Gjatë periudhës 2019 – 2023 kanë pezulluar statusin e nëpunsit civil 7 punonjës, nga të cilët:

- 5 punonjës nuk kanë paraqitur kërkesë për rikthimin e tyre në pozicionin e mëparshëm të punës.
- 1 punonjës është rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës.
- 1 punonjës nuk është rikthyer në vendin e tij të mëparshëm të punës për shkak të plotësimit të pozicionit të punës nga DAP, sipas procedurave të shërbimit civil.

4. A i identifikon vetë institucioni talentet brenda organizatës? Nëse po, cilat janë kriteret që përdoren? Nëse jo, a është diskutuar ndonjëherë kjo çështje brenda institucionit?

Autoriteti i Aviacionit Civil promovon sistemin e brendshëm të karrierës duke hapur fillimisht pozicionet menaxheriale të lira brenda organizatës me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe motivimin e stafit. Si pasojë e kësaj politike 13 punonjës janë promovuar me ngritje në detyrë nga institucioni.

Gjithashtu, AAC nëpërmjet procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, i cili kryhet çdo 6 muaj, vlerëson performancën, sjelljen profesionale si dhe nevojën për trajnim dhe zhvillim profesional.